



Skema e Granteve për Investime – LOTI 2

Udhëzues për Aplikim



Korrik 2025



Përkufizimet kryesore

- **Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK)** – Institucioni përgjegjës për regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave të bizneseve në Kosovë.
- **Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)** – Institucion përgjegjës për kontrollin dhe sigurinë ushqimore, mbrojtjen e shëndetit të kafshëve dhe mbikëqyrjen veterinarë në Kosovë.
- **Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB)** – Institucioni përgjegjës për zbatimin e programeve mbështetëse në bujqësi dhe zhvillim rural, duke përfshirë administrimin e subvencioneve dhe granteve për fermerët dhe ndërmarrjet bujqësore.
- **Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)** – Autoriteti përgjegjës për mbledhjen e tatimeve dhe për zbatimin e politikave tatimore në Kosovë.
- **Agroturizmi** – Formë turizmi që zhvillohet në ferma apo prona bujqësore, ku vizitorët përfshihen në aktivitete bujqësore, njihen me traditat rurale dhe përjetojnë jetën në fshat. Qëllimi është të ofrohet një përvojë edukative dhe autentike për jetën dhe punën në bujqësi.
- **Aplikanti** – Term që i referohet çdo personi fizik ose juridik që dorëzon një aplikim në kuadër të kësaj skeme mbështetëse. Në këtë dokument, termi “aplikanti” përdoret në mënyrë neutrale ndaj gjinisë dhe vlen njësoj për gratë dhe burrat, në përputhje me parimet e barazisë dhe gjithëpërfshirjes gjinore.
- **Bimë mjekuese dhe aromatike (BMA)** – Bimë që përdoren për qëllime mjekësore, farmaceutike ose aromatike, të cilat mund të mbledhen në mënyrë të egër ose të kultivohen.
- **Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)** – Agjencia gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar për zhvillim.
- **Fermë** – Njësi prodhuese bujqësore, në kuptimin teknik dhe ekonomik, e menaxhuar nga një fermer, ku zhvillohen aktivitete bujqësore dhe rurale. Fermat duhet të jenë të regjistruara në Regjistrin e Fermerëve dhe të kenë Numrin Identifikues të Fermës (NIF).
- **Fermer i ri** – Person fizik që merret me aktivitete bujqësore dhe që, në momentin e dorëzimit të aplikimit, është nën moshën 40 vjeç.
- **HACCP (Analiza e Rrezikut dhe Pikave Kritike të Kontrollit)** – Sistem për sigurinë ushqimore që ndihmon në identifikimin dhe kontrollin e rreziqeve gjatë prodhimit dhe përpunimit të ushqimit.
- **ISO (Organizata Ndërkombëtare për Standardizim)** – Sistem standardesh ndërkombëtare që siguron cilësi dhe siguri në produkte dhe procese të menaxhuara në mënyrë të kontrolluar.
- **Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)** – Institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë.
- **Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)** – Sipas Ligjit për Investimet e Huaja (Ligji Nr. 04/L-220):
 - Ndërmarrje mikro: deri në 9 të punësuar.
 - Ndërmarrje të vogla: nga 10 deri në 49 të punësuar.
 - Ndërmarrjet e mesme: nga 50 deri në 249 të punësuar.
- **Numri Identifikues i Fermës (NIF)** – Numër unik i identifikimit të një ferme, i lëshuar pas regjistrimit në Regjistrin e Fermerëve.
- **Produkte pyjore jo-drusore (PPJD)** – Prodhime me prejardhje nga pyjet që nuk përfshijnë dru. Këtu përfshihen: kërpudhat, frutat pyjore, bimët mjekësore dhe aromatike të egra, mjalti, humusi, torfa, zhavorri, rëra, dheu, mishi i gjahut dhe peshku.
- **Regjistri i Fermerëve** – Listë zyrtare që menaxhohet nga AZHB (Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë), ku regjistrohen të gjithë fermerët që merren me bujqësi ose zhvillim rural. Regjistrimi është i detyrueshëm për të përfituar nga skemat mbështetëse dhe për të marrë NIF-in.

- **Teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK)** – Teknologji që mbulon pajisjet dhe shërbimet për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, përfshirë kompjuterët, rrjetet, softuerët dhe internetin.

1. Informacion i përgjithshëm mbi Skemën e Granteve për Investime

Në përputhje me politikat e zhvillimit rural, Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für International Zusammenarbeit (GIZ), ka lidhur një marrëveshje për zbatimin e programit mbështetës “Mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve” (shih: Ligji Nr. 08/L-252, botuar në Gazetën Zyrtare më 8 dhjetor 2023). Zbatimi i këtij programi do të realizohet nga projekti i GIZ “Promovimi i Ndërmarrësisë”.

1.1 Qëllimi kryesor i Skemës së Granteve për Investime

Ky program synon të nxitë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në zonat rurale të Kosovës, me theks të veçantë në rajonet malore dhe ato kufitare. Për realizimin e këtij qëllimi, programi do të mbështesë diversifikimin e aktiviteteve bujqësore dhe ekonomike në këto zona, në përputhje me Masën 7 të Programit Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023–2027 të MBPZHR-së.

Qëllimet kryesore përfshijnë krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e të ardhurave, zhvillimi i ekonomisë lokale dhe promovimi i barazisë gjinore. Programi synon gjithashtu të nxisë inovacionin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë mjedisore në këto komunitete.

2. LOTI 2 – Udhëzues për Aplikim

2.1 Nënsektorët e mbështetur

Loti 2 i Skemës së Granteve për Investime synon të mbështesë fermerët dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), të cilat tashmë operojnë ose planifikojnë të nisin aktivitete ekonomike në nënsektorët e mëposhtëm:

- 701 Produkte pyjore jo-drusore (PPJD) dhe bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) të kultivuara, kërpudha, dhe bimë zbukuruese;
- 702 Agroturizmi;
- 703 Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe në ekonomitë familjare
- 704 Prodhimi i mjalit;
- 705 Aktivitetet jo-bujqësore;
- 706 Rritja e shpezëve për prodhimin e vezëve dhe mishit;
- 707 Akuakultura.

2.2 Objektivi kryesor

Objektivi kryesor i Lotit 2 është të nxisë diversifikimin e aktiviteteve ekonomike në shtatë nënsektorët e përmendur më sipër. Ky lot synon të mbështesë aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, ruajtjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore, krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe sjelljen e përfitimeve publike për komunitetet rurale.

Udhëzimet më poshtë kanë të bëjnë me mënyrën e plotësimit të aplikimit të plotë për projektet investuese në kuadër të Lotit 2.

2.3 Pakoja e aplikimit për LOT 2

Pas shpalljes së thirrjes për Lotin 2, aplikantët duhet të dorëzojnë pakon e plotë të aplikimit. Të gjitha informacionet dhe formularët e nevojshëm janë të përfshira në pakon e aplikimit, e cila përbëhet nga::

- Udhëzues për aplikim për Skemën e Granteve për Investime – Loti 2
- Shtojca 1: Formulari i aplikimit – Loti 2
- Shtojca 2: Propozimi teknik
- Shtojca 3: Buxheti, kthimi i investimit dhe rrjedha e parasë (file Excel)
- Shtojca 4: Lista e dokumenteve mbështetëse
- Shtojca 5: Deklaratat

2.4 Aplikantët e pranueshëm

Aplikimi në kuadër të Lotit 2 është i hapur për këto kategori:

1. **Fermerët e regjistruar dhe anëtarët e ekonomive familjare bujqësore**- Të drejtë aplikimi kanë fermerët që janë të regjistruar në Regjistrin e Fermerëve dhe posedojnë certifikatën e Numri Identifikues i Fermës (NIF), në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-072 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 8, datë 29 mars 2023).
2. **Ndërmarrjet** - Sipas Ligjit Nr. 04/L-220 për Investimet e Huaja (Gazeta Zyrtare nr. 1, datë 9 janar 2014), të pranueshme janë NMVM-të. Ndërmarrja duhet të jetë e regjistruar në ARBK, duke specifikuar aktivitetin afarist për të cilin po aplikon.

Vërejtje: Për qëllimet e këtij programi, termi “ekonomi familjare” nënkupton të gjithë anëtarët që përdorin të njëjtat asete bujqësore, si toka, makineritë, hapësirat e magazinimit, bagëtitë, hambarët dhe objektet ndihmëse. Një ekonomi familjare mund të ketë vetëm një NIF. Në rast se brenda një ekonomie familjare figurojnë më shumë se një NIF, aplikimi do të refuzohet.

2.5 Kriteret e përgjithshme të pranueshmërisë

:

- Të gjithë aplikantët duhet të dëshmojnë se nuk janë dënuar për vepra penale, përfshirë korrupsionin.
- Të gjithë aplikantët duhet të deklarojnë se nuk kanë asnjë detyrim financiar ndaj MBPZHR-së apo Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB).
- Të gjithë aplikantët duhet të dëshmojnë se kanë të drejtën e shfrytëzimit të hapësirës ku do të realizohet investimi, qoftë përmes pronësisë apo marrëveshjes së qirasë:
 - Në rast pronësie, duhet të dorëzohet certifikata/akti i pronësisë dhe kopja e planit të vendndodhjes.

- Në rast prone familjare, duhet të deklarohet se të gjithë trashëgimtarët pajtohen me përdorimin e saj sipas projektit; në rast bashkëpronësie, duhet të deklarohet se të gjithë bashkëpronarët pajtohen me përdorimin e saj sipas projektit.
- Në rast se prona është e marrë me qira, duhet të dorëzohet një kontratë qiraje të noterizuar, me afat jo më të shkurtër se tre (3) vjet, që nis nga viti i aplikimit
- Të gjithë aplikantët duhet të kenë përfunduar arsimin fillor të detyrueshëm (8 ose 9 vite). Në rast se aplikimi bëhet nga një subjekt juridik, ky kriter zbatohet për pronarin/pronaren ose përfaqësuesin/përfaqësuesen e autorizuar.
- Të gjithë aplikantët duhet të dëshmojnë se bilanci në llogarinë bankare të aplikuesit gjatë 6 muajve të fundit ka qenë të paktën 25% e shumës së kontributit vetanak.. Ju lutemi vini re se kontributi vetanak përbën 30% të kostove totale të pranueshme të investimit.
- Në rast se aplikanti është fermer i regjistruar dhe ka një NIF, nuk ka nevojë të regjistrohet në ARBK për qëllimet e kësaj thirrjeje.
- Personat juridikë duhet të dëshmojnë se kanë shlyer ose kanë rregulluar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë tatimin mbi të ardhurat, tatimin në pronë dhe taksat e tjera përkatëse.
- Në rast se aplikanti është NMVM dhe ka deklaruar se ka të punësuar, duhet të vërtetojë se ka paguar kontributet pensionale për punëtorët gjatë gjashtë (6) muajve të fundit.
- Në rast se projekti i një NMVM-je nuk menaxhohet nga vetë pronari, atëherë duhet të caktohet një përfaqësues ligjor i autorizuar për menaxhimin e tij.
- Të gjithë përfituesit që kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja pune dhe kanë marrë pikë shtesë për këtë, duhet t'i krijojnë këto vende dhe ta vërtetojnë përmes pagesës së kontributeve pensionale dhe tatimeve mbi pagat. Këto vende pune duhet të krijohen jo më vonë se një (1) muaj para dorëzimit të makinerive dhe pajisjeve, dhe të mbahen për tre (3) vjet me punonjës me orar të plotë, gjatë periudhës së monitorimit.
- Nuk lejohet financimi i dyfishtë. Investimet e propozuara (si pajisje, makineri etj.) nuk duhet të kenë përfituar financim nga ndonjë donator ose institucion tjetër.
- Investimi duhet të kryhet në zonat rurale. Sipas përkufizimit të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SBZhR 2022–2028), qytetet e Prishtinës / Priştina, Prizrenit / Prizren, Gjilanit / Gnjilane, Pejës / Peć, Mitrovicës / Mitrovica, Ferizajt / Uroševac dhe Gjakovës / Đakovica klasifikohen si zona urbane, ndërsa të gjitha zonat e tjera të territorit të Kosovës konsiderohen si zona rurale.
- Përparësi kanë projektet që zbatohen në zona malore, siç përcaktohet në SBZhR 2022–2028 dhe siç është prezantuar në Programin Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023–2027 – Aneksi 3.
- Të gjithë përfituesit janë të detyruar të mirëmbajnë investimet e tyre, sipas projektit të miratuar, për një periudhë tre (3) vjeçare pas përfundimit të zbatimit, e cila përkon me periudhën e monitorimit. Nëse investimi nuk ruhet sipas kushteve të projektit, përfituesi është i obliguar të kthejë pajisjet ose shumën financiare që përfaqëson vlerën e tyre.
- Çdo aplikant ka të drejtë të përfitojë vetëm një grant për një projekt, në kuadër të kësaj Skeme të Granteve për Investime.
- Investimet duhet të jenë në përputhje me standardet minimale kombëtare, përfshirë ato të sigurisë ushqimore, mbrojtjes së mjedisit dhe mirëqenies së kafshëve. Përfituesit që nuk janë të licencuar ose të regjistruar, duhet të nisin procedurat për licencim apo regjistrim jo më vonë se në ditën e pranimi të pajisjeve.
- Në rast se aplikanti është personat juridikë, qarkullimi vjetor i aplikantit në vitin e fundit duhet të jetë të paktën i barabartë me shumën totale të kostos së investimit të propozuar në projekt.

2.6 Investimet e pranueshme dhe të papranueshme

Njoftim:

Shuma e grantit do të përcaktohet në bazë të investimeve që kualifikohen si të pranueshme për projektin. Aplikantët nuk do të marrin grant në para të gatshme apo në ndonjë formë tjetër të barasvlershme me para. Pajisjet do të blihen nga autoriteti kontraktues dhe do t'u dorëzohen përfituesve. Çdo pajisje që mbulohet nga kontributi vetanak i përfituesit duhet të blihet nga vetë përfituesi. Këto investime duhet të jenë drejtpërdrejt të lidhura me projektin dhe të bazohen në çmime reale të tregut, të cilat duhet të dëshmojnë përmes dokumenteve mbështetëse (oferta, fatura të furnitorëve, deklarata bankare). Këto dokumente do të kontrollohen përpara dorëzimit të pajisjeve të prokuruar nga autoriteti kontraktues.

2.6.1 Investimet e pranueshme

Këto janë kategoritë e investimeve që mund të mbështeten përmes grantit:

- Pajisje dhe makineri të reja, përfshirë edhe pajisje kompjuterike (harduer) dhe programe kompjuterike (softuer), që lidhen drejtpërdrejt me projektin e miratuar të investimit.
- Makineri për paketim dhe etiketim, që përdoren për prezantimin dhe përgatitjen e produkteve për treg.
- Investime në energji të ripërtëritshme për nevoja vetanak janë të pranueshme vetëm nëse përfshijnë sisteme me panele diellore. Investimi konsiderohet i pranueshëm nëse kapaciteti teorik i prodhimit të energjisë nuk e kalon 120% të konsumit mesatar vjetor të energjisë elektrike të ekonomisë familjare gjatë tre viteve të fundit. Gjatë vlerësimit duhet të merren parasysh edhe rritjet e mundshme të konsumit si rezultat i investimit të ri.
- Investime në menaxhimin e mbeturinave, në përputhje me natyrën e aktivitetit dhe objektivat e projektit, si për shembull pajisje për riciklim ose kompostim.

Përfshirje për investimet e mbuluara nga kontributi vetanak

Në kuadër të kontributit vetanak (pjesa e investimit që përfituesi e mbulon me mjete të veta financiare), pranohen edhe këto lloje investimesh:

- Ndërtimet, zgjerimet dhe rinovimet, si dhe kostot për materialet dhe punimet ndërtimore. Këto shpenzime janë të pranueshme vetëm nëse realizohen pas nënshkrimit të kontratës.
 - Në rastet kur kërkohet leje ndërtimi, përfituesi duhet të sigurojë miratimin nga autoriteti kompetent (komuna), në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-110 për Ndërtimin dhe Udhëzimet Administrative përkatëse. Ky miratim duhet të merret para datës së dorëzimit të pajisjeve.
 - Nëse për investimin kërkohet Pëlqimi Mjedisor, ky proces duhet të jetë përfunduar përpara dorëzimit të pajisjeve, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
 - Përfituesit që aplikojnë në kuadër të nënpëmasës 703 për Agroturizëm dhe që planifikojnë të investojnë në objekte të përfshira në Listën e Trashëgimisë Kulturore duhet të sigurojnë miratimin nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), përkatësisht nga Departamenti i Trashëgimisë Kulturore, gjithashtu para dorëzimit të pajisjeve.
 - Shërbimet për projektim arkitektonik janë të pranueshme deri në 10% të shumës së investimit për ndërtim, zgjerim ose rinovim.

- Ju lutemi vini re se të gjitha punimet ndërtimore duhet të realizohen nga aplikanti para dorëzimit të pajisjeve të prokuruar nga autoriteti kontraktues
- Shpenzimet për marketing të produktit janë të pranueshme deri në 10% të kostos totale të investimit. Këtu përfshihen shërbime si: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, broshurave, fletëpalosjeve, posterëve, zhvillimi i faqeve të internetit, krijimi i identitetit të markës dhe të ngjashme.

2.6.2 Investimet e papranueshme

- Punimet e ndërtimit, zgjerimit apo rinovimit, përfshirë materialet ndërtimore dhe punën ndërtimore nga autoriteti kontraktues.
- Blerja e tokës ose e ndërtesave ekzistuese.
- Blerja e pajisjeve apo makinerive të përdorura.
- Blerja e të drejtave për prodhimin bujqësor, si dhe e bimëve njëvjeçare dhe mbjellja e tyre.
- Marrja me qira financiare (leasing), përfitimi i qiradhënësit (marzha), kostot për rifinancimin e interesit, shpenzimet e përgjithshme (administrative) dhe tarifat e sigurimit.
- Shpenzimet e bëra nga aplikanti.
- Shpenzimet operative të fermës apo biznesit, si inputet bujqësore, materiale, paga, punime mirëmbajtjeje, shërbime, qira, etj.
- Shpenzimet që nuk kanë lidhje me projektin e investimit.
- Shpenzimet për blerjen e pajisjeve ose mjeteve që do të zëvendësojnë ato që janë financuar me grant gjatë pesë (5) viteve të fundit.
- Normat e interesit, tatimet, detyrimet doganore, kostot për licenca, si dhe humbjet nga kurset e këmbimit valutor.
- Kontribut jo-monetar, si për shembull puna apo materialet e siguruar nga vetë aplikanti/aplikantja.
- Investimet e realizuara para nënshkrimit të kontratës me autoritetin kontraktues.

2.7 Kriteret specifike të pranueshmërisë dhe investimet e pranueshme sipas nënsektorëve

Përveç kriterëve të përgjithshme të pranueshmërisë, aplikantët duhet të përmbushin edhe kriteret specifike të pranueshmërisë të përcaktuara për secilin nënsektor, siç janë paraqitur më poshtë.

2.7.1 Produkte pyjore jo-drusore (PPJD) dhe bimë mjekësore dhe aromatike (BMA) të kultivuara, kërpudha, dhe bimë zbukuruese

Mbështetja fokusohet në përmirësimin e praktikave të mbledhjes, grumbullimit, ruajtjes dhe distribuimit të PPJD-ve (përfshirë edhe BMA-të e egra). Gjithashtu, synohet rritja e cilësisë së BMA-ve të kultivuara, kërpudhave dhe bimëve zbukuruese. Përparësi u jepet projekteve që zbatojnë parimet e prodhimit organik.

2.7.1.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë

- Të drejtë aplikimi kanë: fermerët, anëtarët e ekonomive familjare bujqësore, si dhe NMVM-të.
- Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për mbledhjen e PPJD (përfshirë BMA-të e egra), të lëshuar nga Departamenti i Pylltarisë në kuadër të MBPZHR-së. Në rast se

nuk janë të licencuar në momentin e aplikimit, duhet të kenë nisur procedurat për pajisje me licencë jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.

- Në rast se aplikimi ka të bëjë me produkte organike, aplikantët duhet të posedojnë certifikatë të vlefshme për prodhim organik.

2.7.1.2 Investime specifike të pranueshme

- Pajisje për kultivimin dhe vjeljen ose mbledhjen e BMA-ve të kultivuara, kërpudhave të kultivuara dhe bimëve zbukuruese.
- Pajisje për mbledhjen e produkteve pyjore jo-drusore, si p.sh. mjete për mbledhjen e frutave të egra, gërsërë teleskopike (me dorezë të gjatë) për punë në lartësi etj.
- Shporta për bartjen e produkteve të vjelura ose mbledhura.
- Kontejnerë për transportimin e produkteve deri te pikat e grumbullimit.
- Pajisje për peshimin, prerjen, bluarjen, copëtimin, klasifikimin, ndarjen dhe tharjen e produkteve të vjelura ose të mbledhura, (me sistem kontrolli të temperaturës dhe lagështisë.)
- Pajisje për pasterizim dhe sterilizim të produkteve;
- Pajisje për ruajtjen e produkteve (rafte, konstruksione metalike, paleta druri, pajisje për ngarkim dhe shkarkim, etj.).
- Pajisje për monitorimin e cilësisë, si dhe sisteme për kontrollin dhe gjurmueshmërinë gjatë pranimit, ruajtjes, përpunimit, paketimit dhe shpërndarjes së produkteve, përfshirë instrumente laboratorike për analiza (me përjashtim të enëve prej qelqi dhe veglave të vogla laboratorike).
- Pajisje kompjuterike dhe softuerë përkatës, përfshirë sensorë (vetëm ato që lidhen drejtpërdrejt me pajisjet e pranueshme).

2.7.2 Agroturizmi

Mbështetja synon të nxisë diversifikimin e aktiviteteve bujqësore në fermë përmes kombinimit me shërbime turistike si akomodimi, ushqimi dhe pijet (p.sh. hoteleri, bistro) dhe aktivitete rekreative. Përparësi do t'u jepet projekteve që planifikojnë të ofrojnë këto shërbime duke përdorur produkte bujqësore nga prodhimi i tyre ose nga fermerë lokalë, për përgatitjen e ushqimeve për vizitorët dhe/ose për t'u shitur vizitorëve/ turistëve

2.7.2.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë

- Të drejtë aplikimi kanë: fermerët, anëtarët e ekonomive familjare bujqësore, si dhe NMVM-të që janë aktive në fushën e prodhimit bujqësor dhe/ose agroturizmit.
- Për fermerët:
 - Për të qenë të pranueshëm për aplikim, kapacitetet e lejuara pas përfundimit të investimit, nuk duhet të tejkalojnë:
 - o Deri në 16 shtretër për akomodim
 - o Deri në 40 ulëse për ofrimin e ushqimit dhe pijeve
- Për NMVM-të:
 - Për të qenë të pranueshme për aplikim, kapacitetet e lejuara pas përfundimit të investimit, nuk duhet të tejkalojnë:
 - Deri në 30 shtretër për akomodim
 - Deri në 60 ulëse për ofrimin e ushqimit dhe pijeve
- Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Objekteve të Regjistruara ose të miratuara nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), ose të ketë dëshmi që vërteton fillimin e procesit të regjistrimit, jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.
- Për investimet që përfshijnë përpunimin e ushqimit dhe/ose pijeve, nëse legjislacioni kombëtar kërkon pajisjen me licencë për këtë aktivitet, aplikanti duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse të lëshuar nga AUV. Në rast se nuk janë të licencuar në

momentin e aplikimit, duhet të kenë nisur procedurat për pajisje me licencë jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.

2.7.2.2 Investime specifike të pranueshme

- Pajisje për dhomat e mysafirëve në bujtina (si shtretër, dollapë, tavolina, karrige etj.), pajisje sanitare dhe recepsion.
- Pajisje dhe makineri për kuzhinë profesionale, si dhe pajisje të tjera ndihmëse për përgatitjen dhe shërbimin e ushqimeve dhe pijeve.
- Mobilje për restorantet e vogla, hapësirat e degustimit (shijimit) dhe dyqanet brenda fermës.
- Pajisje dhe makineri për organizimin e aktiviteteve rekreative brenda fermës.
- Teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK), si dhe teknologji të tjera digjitale që përdoren në sektorin e mikpritjes (përfshirë, akomodimin, ushqimin dhe pijet, si dhe shërbimet rekreative).

2.7.3 Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe në ekonomitë familjare

Mbështetja synon të nxisë prodhimin e produkteve ushqimore tradicionale dhe atyre me vlerë të shtuar, të cilat përpunohen nga lëndë të para bujqësore të siguruar nga zona lokale dhe rajonale brenda Kosovës.

2.7.3.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë

- Të drejtë aplikimi kanë: fermerët, anëtarët e ekonomive familjare bujqësore, si dhe NMVM-të.
- Aktivitetet e pranueshme përfshijnë përpunimin e produkteve bujqësore primare, si mishi dhe qumështi (nga lopë, dele, dhi etj.), frutat (duke përfshirë frutat e buta dhe rrushin), perimet, drithërat dhe kultura të tjera bujqësore. Lënda e parë duhet të jetë nga prodhimi i vet aplikantit ose të jetë blerë nga fermerë lokalë dhe rajonalë brenda territorit të Kosovës. Lënda e parë e blerë nga fermerët lokalë ose rajonalë duhet të vërtetohet përmes kontratave ose dokumentacionit të vlefshëm që dëshmon marrëveshjen për furnizim.
- Aktivitetet e pranueshme përfshijnë gjithashtu përpunimin e produkteve të brumit, përfshirë lloje të ndryshme të produkteve të pjekura dhe ëmbëlsirave tradicionale.
- Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Objekteve të Regjistruara ose të miratuara nga AUV, ose të ketë dëshmi që vërteton fillimin e procesit të regjistrimit, jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.
- Për investimet që përfshijnë përpunimin e ushqimit dhe/ose pijeve, nëse legjislacioni kombëtar kërkon pajisjen me licencë për këtë aktivitet, aplikanti duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse të lëshuar nga AUV. Në rast se nuk janë të licencuar në momentin e aplikimit, duhet të kenë nisur procedurat për pajisje me licencë jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.
- Në rastin e përpunimit të rrushit, aplikantët duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin e Verërave të Kosovës ose të ketë dëshmi që vërteton fillimin e procesit të regjistrimit, jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.

2.7.3.2 Investime specifike të pranueshme

- Pajisje për prodhimin e salsiçeve/ suxhukut dhe proshutës, për trajtimin e mishit të freskët dhe për paketimin me vakum.
- Makineri për përpunimin e qumështit të papërpunuar në produkte të tilla si djathë, kos, krem, gjalpë dhe produkte të tjera të fermentuara ose me vlerë të shtuar. Këtu përfshihen pasterizues, homogenizues, rezervuarë për ruajtje, ndarës, pajisje për prodhimin e djathit, rezervuarë fermentimi, njësi të lëvizshme për përpunimin e qumështit dhe rimorkio të vogla për transportin e tyre.

- Pajisje për përpunimin e frutave në produkte si lëngje, marmelata, reçel, uthull, verë dhe pije alkoolike. Këtu përfshihen shtypës, grirës, presa, pasterizues, filtra dhe rezervuarë për fermentim apo distilim.
- Pajisje për tharjen dhe përpunimin e produkteve të thata, erëzave, produkteve bimore të përgatitura nga fruta, perime dhe BMA-të. Këtu përfshihen tharëse diellore, tharëse me ajër apo mekanike, makineri për prerje dhe grirje, pajisje për klasifikim, mullinj/bluarëse dhe sita.
- Pajisje për përzierje, përgatitjen e ekstrakteve dhe prodhimin e çajit, duke përfshirë edhe makineri për paketimin e qeseve të çajit.
- Pajisje për pastrimin, larjen, klasifikimin dhe paketimin e perimeve, si dhe objektet ndihmëse për ruajtjen e tyre.
- Pajisje për prodhimin e bukës, ëmbëlsirave, biskotave dhe tortave. Këtu përfshihen mikserë, grirës, tenxhere, furra, pajisje për matjen e peshës, tava për ëmbëlsira dhe sisteme për ftohje.
- Pajisje të vogla dhe orendi për shitje të drejtpërdrejtë në ferma ose ekonomi familjare, si rafte, frigoriferë dhe tavolina.
- Makineri për përpunimin e drithërave, arroveve dhe bishtajoreve në produkte me vlerë të shtuar.
- Pajisje për ruajtje e produkteve në temperaturë të ulët, si frigoriferë dhe ngrirës, për të ruajtur cilësinë e produktit.
- Sisteme sanitare dhe pajisje për pastrim, për të siguruar higjienën dhe sigurinë ushqimore.
- Pajisje kompjuterike dhe softuerë përkatës, përfshirë sensorë (vetëm ato që lidhen drejtpërdrejt me pajisjet e pranueshme), për qëllime të automatizimit të proceseve, kontrollit të cilësisë dhe menaxhimit të të dhënave.
- Investime në pajisje të nevojshme për zbatimin e sistemit të analizës së rrezikut dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP) dhe standardeve ndërkombëtare ISO.

2.7.4 Prodhimi i mjaltit

Mbështetja synon rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e produktivitetit të mjaltit në zonat rurale. Përkrahja u dedikohet si bletarëve që synojnë të zgjerojnë ose të përmirësojnë aktivitetin e tyre në fushën e bletarisë.

2.7.4.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë

- Të drejtë aplikimi kanë: fermerët, anëtarët e ekonomive familjare bujqësore, si dhe NMVM-të.
- Aplikantët duhet të kenë së paku 50 koshere bletësh në momentin e aplikimit.
- Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Objekteve të Regjistruara ose të miratuara nga AUV, ose të ketë dëshmi që vërteton fillimin e procesit të regjistrimit, jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.

2.7.4.2 Investime specifike të pranueshme

- Koshere bletësh me inventar (koshere me dysHEME kundër varroas).
- Pajisje për trajtimin e bletëve, si tymëse, furçë, si dhe pajisje për kontrollin e cilësisë së mjaltit.
- Pajisje për nxjerrjen e mjaltit (centrifuga, mjete për hapjen e hojeve të mjaltit).
- Shkrires dylli për hoje.
- Pajisje për mbushje dhe ruajtje të mjaltit.
- Pajisje për shitje në ferma, ekonomitë familjare dhe tregje.
- Pajisje për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të bletëve.
- Pajisje për prodhimin e nënprodukteve të mjaltit, si polen, qumësht mbretëreshë, propolis).
- Pajisje për nxjerrjen e qumështit mbretëreshë dhe rritjen e mbretëreshës. Këtu përfshihen gjilpëra për transferimin e larvave, spatula për nxjerrjen e qumështit

mbretëreshë, pajisje për matjen e temperaturës dhe lagështisë, pajisje për rritjen e larvave, kafaze për transportin e mbretëreshës, nukleuse për çiftëzim (maksimumi 100 njësi), koshere speciale për çiftëzimin e mbretëreshës (maksimumi 100 njësi), frigorifer për transport, frigorifer me ngrirje të thellë dhe inkubator.

2.7.5 Aktivitetet jobujqësore

Mbështetja synon përmirësimin e artizanatit tradicional në zonat rurale përmes përdorimit të pajisjeve moderne, materialeve lokale dhe ofrimit të shërbimeve që mbështesin bujqësinë dhe popullsinë rurale.

2.7.5.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë

- Të drejtë aplikimi kanë: fermerët, anëtarët e ekonomive familjare bujqësore, si dhe NMVM-të
- Aktivitetet jo-bujqësore të pranueshme përfshijnë:
 - Përpunimi dhe prodhimi i lëkurës, leshit, drurit, metalit, letrës/kartonit, gurit, qeramikës/poçarisë dhe produkteve me bazë tekstili.
 - Prodhimi i humusit.
 - Produkte dhe shërbime që lidhen me nënsektorët e pranueshëm në këtë thirrje.

2.7.5.2 Investime specifike të pranueshme

- Pajisje teknike për prodhimin dhe përpunimin e lëkurës, leshit të deleve, drurit, metalit, qelqit, gurit, argjilës për qeramikë/poçari, tekstilit dhe produkteve të letrës/kartonit.
- Pajisje teknike për prodhimin e humusit.
- Pajisje dhe materiale për pikat e shitjes të produkteve.
- Pajisje për ofrimin e shërbimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes së makinerive bujqësore.
- Pajisje për magazinimin dhe shpërndarjen e produkteve.
- Pajisje kompjuterike dhe softuerë përkatës, përfshirë sensorë (vetëm ato që lidhen drejtpërdrejt me pajisjet e pranueshme).
- Pajisje për prodhimin e artikujve që lidhen me nënsektorët e pranueshëm në këtë thirrje.

2.7.6 Rritja e shpezëve për prodhim të vezëve dhe mishit

Mbështetja synon të nxisë zhvillimin e blegtorisë së shpezëve, në shkallë të vogël, për prodhimin e mishit dhe vezëve, si një sektor me potencial në rritje në tregun vendas. Fokusi është në përmirësimin e produktivitetit, sigurimin e sigurisë ushqimore dhe promovimin e standardeve të mirëqenies së kafshëve.

2.7.6.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë

- Të drejtë aplikimi kanë: fermerët, anëtarët e ekonomive familjare bujqësore, si dhe NMVM-të.
- Numri minimal i kafshëve që duhet të jenë të pranishme në momentin e aplikimit dhe në përfundim të projektit:

Numri minimal i kafshëve në aplikim	Numri minimal i kafshëve në fund të projektit
-------------------------------------	---

Pula vojse (pula për vezë): 300	Pula vojse (pula për vezë): 800
Brojler (pula për mish): 500	Brojler (pula për mish): 1,500
Rosa: 300	Rosa: 800
Pata: 100	Pata: 500
Gjeldeti: 100	Gjeldeti: 500

- Në rastin e mbajtjes së kombinuar, një patë ose një gjeldet është e barabartë me tre (3) pula dhe tre (3) rosa, dhe duhet të arrihet numri ekuivalent me vlerat e lartpërmendura.
- Sipërfaqja minimale e kërkuar është: 5 m² për çdo pulë ose rosë, dhe 15 m² për çdo patë ose gjeldeti, në përputhje me standardet për mirëqenien e kafshëve.
- Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Objekteve të Regjistruara ose të miratuara nga AUV, ose të ketë dëshmi që vërteton fillimin e procesit të regjistrimit, jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.
- Për investimet që përfshijnë përpunimin e produkteve shtazore, nëse legjislacioni kombëtar kërkon pajisjen me licencë për këtë aktivitet, aplikanti duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse të lëshuar nga AUV. Në rast se nuk janë të licencuar në momentin e aplikimit, duhet të kenë nisur procedurat për pajisje me licencë jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.

2.7.6.2 Investime specifike të pranueshme

- Rrethoja për mbajtjen e shpezëve në hapësira të lira.
- Kuti për fole dhe shtëpiza të lëvizshme.
- Inkubatorë të vegjël që përputhen me kapacitetin e prodhimit.
- Enë për ujë të pijshëm për shpezët.
- Enë për ushqim shpezëve.
- Pajisje për pastrimin, klasifikimin dhe paketimin e vezëve.
- Pajisje për largimin, trajtimin dhe ruajtjen e plehut organik.
- Sistemet e ushqyerjes

2.7.7 Akuakultura

Mbështetja synon të nxisë kultivimin e peshkut në ujëra të ëmbla, në shkallë të vogël, si një mundësi e vlefshme për diversifikimin e të ardhurave për familjet rurale dhe ndërmarrjet e vogla. Përkrahja përfshin pajisje dhe mjete themelore që janë të nevojshme për të siguruar cilësinë, higjienën dhe qëndrueshmërinë e prodhimit të peshkut.

2.7.7.1 Kriteret specifike të pranueshmërisë

- Të drejtë aplikimi kanë: fermerët, anëtarët e ekonomive familjare bujqësore, si dhe NMVM-të.
- Aplikantët duhet të kenë një prodhim vjetor të peshkut të freskët prej së paku 5 ton në momentin e aplikimit.
- Aplikantët duhet të jenë të regjistruar në Regjistrin Qendror të Objekteve të Regjistruara ose të miratuara nga AUV, ose të ketë dëshmi që vërteton fillimin e procesit të regjistrimit, jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.
- Aplikantët duhet të posedojnë licencë të vlefshme për aktivitetet e akuakulturës / kultivimin e peshkut nga MBPZHR. Në rast se nuk janë të licencuar në momentin e aplikimit, duhet të kenë nisur procedurat për pajisje me licencë jo më vonë se data e dorëzimit të pajisjeve.

2.7.7.2 Investime specifike të pranueshme

- Pajisje për ajrosjen dhe oksigjenimin e ujit, si dhe për monitorimin e parametrave të tij, duke përfshirë injektorët e ajrit, sensorët e oksigjenit, matësit e temperaturës dhe të pH-së, si dhe pompat për kanalet kryesore dhe anësore.
- Pajisje për mbarështimin dhe inkubimin e peshqve, duke përfshirë rezervuarë për larva dhe peshq të vegjël.
- Pajisje (pompa) për klasifikimin dhe transportin e peshqve brenda fermës
- Pajisje për ushqyerjen e peshkut
- Pajisje për transportin e peshqve të gjallë (fuçi/ rezervuarë, bombola oksigjeni dhe pajisje shtesë transporti);
- Pajisje për dezinfektimin, filtrimin dhe pastrimin e ujit, duke përfshirë pompat e ujit, ndarësit e proteinave ose fraksionuesit e shkumës (përfshirë valvulat, tubacionet dhe pajisjet përkatëse).
- Pajisje për ruajtjen e peshkut të freskët, makina për prodhimin e akullit, tanka ftohës (konteinerë, paleta, rimorkio, rimorkio frigoriferike), përfshirë pajisje ndihmëse për ruajtjen e ushqimit, aditivëve dhe për trajtimin, ngarkimin dhe shkarkimin (p.sh. pirunë ngritës, paleta, sisteme me rrip transportues, pajisje për peshim).
- Pajisje për therjen dhe pastrimin e peshkut, si dhe për menaxhimin, deponimin, ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve.
- Pajisje për monitorimin e cilësisë, si dhe sisteme për kontrollin dhe gjurmueshmërinë të lidhura me kultivimin, ruajtjen dhe shpërndarjen, si dhe pajisje kompjuterike dhe softuerë, përfshirë sensorë (vetëm ato që lidhen drejtpërdrejt me pajisjet e pranueshme).

2.7 Kushtet financiare

2.8.1 Blerja e investimit të pranueshëm

Pajisjet dhe makineritë e kërkuara nga aplikanti, si pjesë e projektit të investimit, do të blihen dhe dorëzohen nga autoriteti kontraktues pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet autoritetit kontraktues dhe përfituesit.

2.8.2 Vlera minimale dhe maksimale e investimit (në EUR)

- Shuma minimale e kostove të investimeve të pranueshme për projektin është 5,001 EUR.
- Shuma minimale e kostove të investimeve të pranueshme për projektin është 50,000 EUR.

2.8.3 Intensiteti i ndihmës

Intensiteti i mbështetjes financiare është deri në 70% të kostos së përgjithshme të investimit të pranueshëm.

Autoriteti kontraktues do të sigurojë deri në 70% të kostove të pajisjeve të pranueshme.

Dorëzimi i pajisjeve do të bëhet pasi përfituesi të paraqesë dëshmi se ka paguar pjesën e mbetur prej 30% të vlerës së investimit të pranueshëm.

Çdo artikull i përfshirë në buxhetin e projektit duhet të financohet plotësisht ose nga GIZ (100%) ose nga aplikanti (100%). Nuk lejohet ndarja e kostos për të njëjtin artikull (p.sh., 50% nga GIZ dhe 50% nga aplikanti).

2.8.4 Kohëzgjatja e projektit të investimit

Zbatimi i projektit të investimit duhet të përfundojë brenda një afati maksimal prej dymbëdhjetë (12) muaj.

2.8.5 Raportimi financiar

Përfituesit e grantit duhet të dorëzojnë një raport financiar gjatë kohëzgjatjes së kontratës, përpara se pajisjet të dorëzohen nga autoriteti kontraktues. Në raport duhet të përfshihen investimet e realizuara nga vetë përfituesit si kontribut i tyre, si dhe të justifikohen çdo devijim nga plani fillestar. Detajet lidhur me përgatitjen e raportit financiar do t'u vihen në dispozicion aplikantëve të suksesshëm.

2.7 Procedura për dorëzimin e aplikimit

2.9.1 Thirrja për aplikim

Thirrja për aplikime është publikuar në faqen e internetit dhe në mediat sociale të MBPZHR-së dhe AZHB-së, si dhe në mediat sociale të GIZ-it. Të gjithë përfituesit potencialë ftohen të dorëzojnë aplikimin e tyre.

2.9.2 Periudha e aplikimit dhe metodat e dorëzimit

Thirrja për aplikime do të jetë e hapur për dy (2) muaj. Data e saktë e hapjes dhe mbylljes së afatit për aplikim do të shpallet veçmas. Gjatë kësaj periudhe, formulari i aplikimit së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike përmes këtij linku: <https://rural-development-kosovo.grantplatform.com/>.

Si alternativë, aplikantët mund të dorëzojnë një kopje fizike (të shtypur) të pakos së plotë të aplikimit te Zyrtari për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në komunën përkatëse. Formularët duhet të jenë të plotësuar në mënyrë elektronike (në kompjuter) dhe jo të shkruar me dorë.

2.9.3 Pako e plotë e aplikimit

Aplikantët duhet të dorëzojnë pakon e plotë të aplikimit, që përfshin:

- Formulari i aplikimit (shih Shtojcën 01)
- Propozimi teknik (shih Shtojcën 02)
- Buxheti, Kthimi i Investimit dhe Rrjedha e Parasë (shih Shtojcën 03)
- Dokumente mbështetëse (shih Shtojcën 04)
- Deklaratat (shih Shtojcën 05)

Të gjitha dokumentet duhet të nënshkruhen.

2.9.4 Dokumentet mbështetëse

Dokumentet mbështetëse kërkojnë për të dëshmuar pranueshmërinë e aplikimit dhe për të vërtetuar përputhshmërinë me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranueshmërisë (shih listën e dokumenteve mbështetëse në Shtojcën 04).

2.9.5 Deklaratat

Deklaratat përgatiten paraprakisht; ju lutemi lexoni me kujdes përmbajtjen e tyre. Nënshkrimi dhe pranimi i këtyre deklaratave është i domosdoshëm për vazhdimin e procesit të vlerësimit të aplikimit tuaj (shih deklaratat në Shtojcën 05).

2.9.6 Mbështetje për përgatitjen e aplikimit

Ky udhëzues aplikimi mbështet zhvillimin e një aplikimi të plotë. Përveç kësaj, aplikantët kanë mundësi të marrin pjesë në takime informuese/konsultative falas për t'i ndihmuar në përgatitjen e aplikimit të tyre. Datat dhe vendndodhjet e këtyre takimeve do të publikohen veçmas.

2.9.7 Procesimi i aplikacionit

Aplikacioni i dorëzuar duke përfshirë të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, u nënshtrohet hapave të kontrollit dhe procesit si në vijim

- i. Kontrolli i plotësisë
- ii. Kontrolli i pranueshmërisë
- iii. Kontrolli në terren
- iv. Rangimi e aplikimeve
- v. Përzgjedhja e përfituesve

i. Kontrolli i plotësisë

Të gjitha dokumentet e përfshira në pakon e aplikimit kontrollohen për të verifikuar nëse aplikimi është i plotë. Nëse vërehen mungesa të vogla, aplikantit do t'i dërgohet një kërkesë me shkrim për plotësimin e dokumentacionit. Shembuj të mungesave të vogla përfshijnë:

- Mungesa e disa të dhënave ose dokumenteve brenda formularit të aplikimit
- Mungesa e nënshkrimit në deklaratat përkatëse
- Gabime aritmetike (në kalkulime)
- Të tjera raste të ngjashme

Aplikantit i jepen deri në pesë (5) ditë pune për të dorëzuar dokumentet apo informacionin që mungon. Nëse ky afat nuk respektohet, ose nëse dokumentet nuk dorëzohen sipas kërkesës, aplikimi do të refuzohet.

Në rast të mungesave të konsiderueshme, aplikimi refuzohet menjëherë, pa kërkesë për plotësim. Shembuj të mungesave të mëdha përfshijnë:

- Projekti nuk i përket nënsektorëve të përcaktuar në Lotin 1
- Aplikimi është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar
- Mungon tërësisht formulari i aplikimit

ii. Kontrolli i pranueshmërisë

Ky hap ka për qëllim të përcaktojë nëse aplikimi është i pranueshëm për financim, bazuar në kriteret e përcaktuara në udhëzues. Verifikohet nëse aplikanti plotësohen kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranueshmërisë, nëse janë nënshkruar deklaratat, nëse investimi është i pranueshëm, etj.

iii. Kontrolli në terren (në vendin e projektit)

Kontrolli në terren njoftohet paraprakisht dhe realizohet nga një i kontrollues që do të vizitojë vendndodhjen e projektit. Ky kontroll zhvillohet përpara fazës së renditjes së aplikimeve.

iv. Rangimi i aplikimeve

Aplikimet që kanë kaluar me sukses kontrollin e plotësisë dhe pranueshmërisë, si dhe kanë një raport pozitiv nga kontrolli në terren, kalojnë në fazën e rangimit. Për këtë fazë përdoren kriteret të caktuara përzgjedhjeje dhe pikëzimi (shih tabelën në seksionin 2.10 Kriteret e përzgjedhjes). Aplikacionet rangiten sipas pikëve të arritura. Aplikimet rangohen sipas numrit

të pikëve të grumbulluara, dhe ato me rezultatet më të larta përzgjidhen për financim përmes grantit.

v. Përzgjedhja e përfituesve

Pas rangimit të aplikimeve sipas pikëve, përzgjidhen aplikantët e suksesshëm (përfituesit e grantit) dhe fillojnë procedurat e kontraktimit.

2.10 Kriteret e përzgjedhjes

Do të zgjidhen aplikimet që kanë potencialin të kontribuojnë më së shumti në arritjen e objektivave të grantit dhe konkretisht objektivave të LOTIT 2. Përzgjedhja bëhet sipas kriterëve të përzgjedhjes (shih Tabelën 01 - Tabelën 07) të paracaktuara për secilin nënsektor.

Për promovimin e një qasjeje të orientuar drejt rezultatit, vendoset një prag minimal prej 50 pikësh. Aplikimet nën 50 pikë nuk janë të pranueshme.

Tabela 01. Nënsektori 701 - Produktet pyjore jo-drusore (PJP) duke përfshirë bimët mjekuese dhe aromatike (BMA), kërpudhat dhe bimët zbukuruese

	<i>Kriteret e përzgjedhjes</i>	<i>Pikët</i>
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Investimet synojnë produkte të reja dhe cilësi të përmirësuar	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Projekti forcon bashkëpunimin me banorët lokalë, përfshirë grumbulluesit, fermerët dhe bizneset e tjera, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të zonave rurale.	10
7	Projekti nxit prodhimin organik të BMA-ve të kultivuara, kërpudhave dhe bimëve zbukuruese.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
	<i>Shuma e përgjithshme e pikëve</i>	100

Tabela 02. Nënsektori 702 – Agroturizmi

	<i>Kriteret e përzgjedhjes</i>	<i>Pikët</i>
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Projekti synon të krijojë shërbime të reja dhe të përmirësojë cilësinë në fushën e agroturizmit.	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë, biznese dhe aktorë lokalë për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale.	10
7	Investime në aktivitete ose produkte të trashëgimisë kulturore	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
	<i>Shuma e përgjithshme e pikëve</i>	100

Tabela 03. Nënsektori 703 Përpunimi i produkteve bujqësore në fermë dhe në ekonomitë familjare

	<i>Kriteret e përzgjedhjes</i>	<i>Pikët</i>
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Projekti synon të mbështesë prodhimin e produkteve me vlerë të shtuar më të lartë, si edhe të produkteve tradicionale.	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Përpunimi i lëndëve të para bujqësore të prodhuara kryesisht në nivel lokal ose rajonal, brenda territorit të Kosovës.	10
7	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë, biznese dhe aktorë lokalë për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik të zonave rurale.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
	<i>Shuma e përgjithshme e pikëve</i>	100

Tabela 04. Nënsektori 704 - Prodhimi i mjaltit

	<i>Kriteret e përzgjedhjes</i>	<i>Pikët</i>
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Projekti synon përmirësimin e cilësisë së mjaltit dhe produkte të reja nga bletaria	15
5	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
6	Projekti forcon bashkëpunimin ndërmjet prodhuesve të mjaltit dhe bizneseve lokale, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik në zonat rurale.	10
7	Projekti synon të rrisë numrin e koshereve të bletëve dhe të shtojë sasinë e prodhimit të mjaltit.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
	<i>Shuma e përgjithshme e pikëve</i>	100

Tabela 05. Nënsektori 705 - Aktivitete jo-bujqësore

	<i>Kriteret e përzgjedhjes</i>	<i>Pikët</i>
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Projekti synon të mbështesë artizanatin tradicional dhe zhvillimin e produkteve të reja.	10
5	Projekti synon investime në shërbime inovative për ekonominë rurale, bujqësinë dhe sektorin ushqimor.	10
7	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë, restorante dhe biznese të agroturizmit, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të zonës rurale.	10
6	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	7
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
	<i>Shuma e përgjithshme e pikëve</i>	100

Tabela 06. Nënsektori 706 - Rritja e shpendëve për prodhimin e vezëve dhe mishit

	<i>Kriteret e përzgjedhjes</i>	<i>Pikët</i>
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Projekti fokusohet në përmirësimin e cilësisë së produkteve nga shpendët, përkatësisht vezëve dhe mishit, duke kontribuar në sigurinë ushqimore dhe rritjen e konkurrueshmërisë në treg.	15
5	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë, restorante dhe biznese të agroturizmit, me qëllim nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të zonës rurale.	10
6	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
7	Projekti synon të thellojë nivelin e përpunimit brenda zinxhirit të vlerës.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
	<i>Shuma e përgjithshme e pikëve</i>	100

Tabela 07. Nënsektori 707 – Akuakultura

	<i>Kriteret e përzgjedhjes</i>	<i>Pikët</i>
1	Projekti kontribuon në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike	15
2	Projekti krijon vende të reja pune dhe/ose ruan vendet ekzistuese të punës	15
3	Projekti promovon përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore (p.sh. riciklimi, ripërdorimi i ujit, shfrytëzimi me vlerë i mbetjeve, përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për konsum vetanak, etj.)	15
4	Projekti synon të përmirësojë cilësinë e peshkut të freskët dhe produkteve të përpunuara të peshkut.	15
5	Projekti forcon bashkëpunimin me fermerë të tjerë të peshkut, biznese turistike dhe restorante lokale, si dhe me aktorë të tjerë lokalë, për të nxitur zhvillimin socio-ekonomik të zonës rurale.	10
6	Projekti zbatohet në një zonë malore	10
7	Projekti synon kultivimin e varieteteve të reja të peshkut.	7
8	Aplikanti është fermer ose ndërmarrës i ri (nën 40 vjeç në momentin e aplikimit).	5
9	Aplikanti është grua	5
10	Aplikanti i përket një grupi minoritar	3
	<i>Shuma e përgjithshme e pikëve</i>	100

2.10 Çështje tjera

2.10.1 Njoftim mbi vendimin për aplikacionin

Aplikantët do të njoftohen me shkrim për vendimin e marrë nga autoriteti kontraktues në lidhje me aplikimin e tyre. Në rast se aplikimi është vlerësuar pozitivisht, aplikantët do të ftohen për të nënshkruar marrëveshjen e grantit. Në rast të refuzimit, autoriteti kontraktues do t'i informojë me shkrim për arsyet e këtij vendimi.

2.10.2 Ankesat

Aplikantët kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim drejtpërdrejt në e-mail adresën: ep.kosovo@giz.de, brenda tetë (8) ditëve pune nga data kur është lëshuar njoftimi për refuzimin e aplikimit. Në ankesë duhet të shpjegohet pse aplikanti beson se vendimi për refuzim është i pasaktë dhe nëse ka ndonjë tregues të gabimeve apo parregullsive gjatë procesit të përzgjedhjes.

2.10.3 Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve nga përfituesi

Pas nënshkrimit të kontratës, përfituesi fillon procesin e blerjes së artikujve të investimit duke kërkuar oferta nga furnizues potencialë. Ju lutemi vini re se çdo ofertë apo blerje e realizuar para datës së nënshkrimit të kontratës nuk është e pranueshme. Kompanitë e ftuara për të paraqitur oferta nuk duhet të jenë të lidhura ndërmjet tyre apo me aplikantin (nuk duhet të jenë të afërm ose të lidhura në mënyrë biznesore).

Ftesa për furnizuesit duhet të përmbajë specifikimet teknike (lloji, modeli, kapaciteti, fuqia dhe karakteristikat kryesore) për secilin artikull investimi për të cilin kërkohet ofertë. Ofertat duhet të përfshijnë këta elementë kryesorë:

- data e lëshimit të ofertës,
- emri i furnizuesit,
- numri i regjistrimit në regjistrin e bizneseve,
- referenca ndaj ftesës për paraqitjen e ofertës,
- specifikime teknike të detajuara për pajisjet dhe makineritë, shërbimin e instalimit dhe testimin,
- çmimi, përfshirë zbritjet (neto, TVSH dhe taksat e tjera të specifikuara veçmas),
- vlefshmëria e ofertës, e vërtetuar me nënshkrimin e përfaqësuesit ligjor.

Përfituesi kryen krahasimin e ofertave të pranuar. Nëse nuk përzgjidhet oferta me çmimin më të ulët për pajisjet e kërkuara, aplikanti duhet të paraqesë një justifikim të arsyetuar për vendimin.

Gjuha e ofertave mund të jetë shqipe dhe/ose serbe. Në rast se ofertat paraqiten në një gjuhë tjetër, ato duhet të përkthehen.

2.10.4 Dukshmëria

Çdo përfitues duhet të vendosë në një vend të dukshëm një pllakë informuese që tregon se investimi është bashkëfinancuar nga Projekti **“Mbështetje për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve”** me mbështetje financiare nga Qeveria e Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ). Udhëzimet për madhësinë, llojin e shkronjave dhe logot do të ofrohen nga autoriteti kontraktues.

2.10.5 Vërejtje përfundimtare

Autoriteti kontraktues nuk do të mbulojë asnjë kosto apo shpenzim të bërë nga aplikantët gjatë aplikimit. Gjithashtu, autoriteti kontraktues rezervon të drejtën të pranojë ose të refuzojë plotësisht çdo ofertë, të anulojë ose të përsërisë procedurën në çdo moment përpara nënshkrimit të kontratës, pa mbajtur asnjë përgjegjësi ndaj aplikantëve dhe pa pasur detyrimin të japë ndonjë arsyetim për një vendim të tillë.